

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7614 E mërkurë 8 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Deutsche Welle"
Më 2017-ën, prof. Phillips publikoi një raport lidhur me dialogun Kosovë-Serbi. Në të theksohet që dialogu duhet të përgjendrohet te rezultatit e jo tek procesi...
Vijon në faqen 20

Nga AIDA CAMA
David L. Phillips për dialogun Kosovë-Serbi: Ndarje, në asnjë mënyrë



Opinion i Ditës
"Nuk është e vërtetë!", mund të të thonë, gati me revoltë jo pak specialistë në ministritë ekonomike të vendit. "Të ardhurat nga tatimet dhe doganat kanë..."
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI
Pse bien të ardhurat e Buxhetit të Shtetit?



ATP: Vendimet për dy vite, ja kush përfiton

Agjencia e Pronave, dosjet e 2013-2014, lista me pronarët që marrin paratë

Përfituesit kanë gjashtë muaj kohë për të plotësuar dokumentet

Nga ORNELA MANJANI
Agjencia e Trajtit të Pronave publikon listën me pronarët që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 2013 dhe 2014, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me...
Në faqen 6

INTERVISTA EKSKLUZIVE/RAPORTUESI PER SHQIPERINE FLET PER ÇELJEN E NEGOCIATAVE ME BE

FLECKENSTEIN: PS-PD TE ULEN NE DIALOG

"Keqardhje që nuk pati marrëveshje për magistraturën. Nuk mund të menaxhojmë çdo mosmarrëveshje në Shqipëri. Opozita të gjejë rrugën për të kundërshtuar parregullsitë"



(Në foto) Raportuesi për Shqipëri në Parlamentin Evropian, Knut Fleckenstein
Në faqen 3

INVESTIMI 51 MLN EURO
Baza ajrore e Kuçovës, NATO: Rrisim sigurinë në Ballkan, zbardhen detajet e projektit
Në faqen 2

DEBATI PER KUFIJTE
Berisha, Thaçit: E mjerueshme, s'pastrohesh dot me mbetje të kuzhinës së Beogradit
Në faqen 2

UDHEZIMI I MASR
Zbardhen kategoritë e nxënësve që do të marrin tekste shkollore falas
Në faqen 11

TOKAT NE SHQIPERI
Strasburgu u jep 4 miliardë lekë pronarëve që fituan gjyqet, lista e plotë
Në faqen 7

LISTA E RE E ATP DHE SHUMA QE PERFITOJNE



Regjistri i pronave për 12 qarqe në vend, 3700 personat që u njihet e drejta
Në faqen 17-19

Policia, masa shtesë sigurie për mbarëvajtjen e aktivitetit gjigant

Nis festa e 'Birrës Korça', dyndje turistësh

Pesë net argëtim, muzikë dhe birra deri në mëngjes

Në qytetin e serenatave sot nis Festa e Birrës. Një festë kjo tradicionale e përvitshme, që mbledh në Korçë jo vetëm vizitorë shqiptarë, por edhe qindra turistë të huaj që presin të shijojnë birrën e famshme shqiptare, "Birra Korça", që i ka dhënë edhe emrin kësaj feste.



Çdo gjë është gati në Korçë, ku janë ngritur stendat dhe është krijuar infrastruktura e nevojshme. Për më tepër, policia e Korçës ka marrë masa shtesë për të siguruar mbarëvajtjen e aktivitetit e për të mos lejuar asnjë cenim të sigurisë. Ashtu si...
Në faqen 9

PROJEKTI REAGIMI

Zbardhen detajet e projektit, Aleanca flet për herë të parë për bazën ajrore në Shqipëri

Baza ajrore e Kuçovës, NATO: Rrisim sigurinë në Ballkan

Cazalet: Investimi kap vlerën e 51 milionë eurove

Ndërtimi i bazës ajrore në Kuçovë nis brenda këtij viti, ndërkohë që do të shërbejë si bazë mbështetëse për NATO-n për furnizim ajror; por do të rrisë edhe sigurinë në Ballkan. Zëdhënësi i NATO-s, Piers Cazalet deklaroi dje se financimi i bazës ajrore në Kuçovë është pjesë e Programit të Investimit të Sigurisë. Investimi sipas tij kap vlerën e 51 milionë eurove. "NATO ka në plan të investojë 51 milionë euro për të modernizuar bazën ajrore të Kuçovës në Shqipëri. Paratë do të shkojnë drejt përmirësimit të infrastrukturës në bazë, përfshirë edhe depot e karburantit", konfirmoi për ATSH, Cazalet. Në prononcimin për ATSH, ai sqaroi më tej se, "financimi është pjesë e Programit të Investimit të Sigurisë së NATO-s, që mbulon projekte kryesore ndëruese në vendet aleate, me qëllim përmirësimin e sigurisë në hapësirën e NATO-s. Ky program është pjesë e financimit të përbashkët të NATO-s në të cilin kontribuojnë të 29 vendet anëtare". Zëdhënësi i NATO-s tha se Aleanca i është mirënjohëse Shqipërisë për kontributin. "Ne jemi mirënjohës për kontributin e çmuar të Shqipërisë për sigurinë tonë të përbashkët, përfshirë misionet tona në Afganistan dhe Kosovë. Shqipëria gjithashtu u jep një mbështetje të fortë partnerëve tanë, përfshirë kontributin në Fondet tona të Kujdestarisë për Ukrainën, ndihmën në mbrojtjen kibernetike dhe tranzicionin e karrierës ushtarake", deklaroi ai. "Shqipëria - theksoi Cazalet për ATSH - luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në luftën kundër ISIS-it, duke kontribuar me pajisje dhe trajnim për Irakun. Shqipëria gjithashtu na ndihmon të rrisim sigurinë duke promovuar bashkëpunimin në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Vendi juaj është një avokat i fortë i politikës së dyerve të hapu-



ra të NATO-s dhe i integrim-it të fqinjëve tuaj në familjen Euro-Atlantike", tha zëdhënësi i NATO-s, Piers Cazalet për ATSH. Përmes këtij projekti, i cili pritet të nisë brenda këtij viti, Kuço-

va do të shërbejë si bazë mbështetëse për NATO-n për furnizim ajror, mbështetje logjistike, mbështetje për policimin ajror si dhe trajnim dhe stërvitje të Aleançës. Kuçova do të shërbejë gjith-

FINANCIMI
Zëdhënësi i NATO-s, Piers Cazalet deklaroi se financimi i bazës ajrore në Kuçovë kap vlerën e 51 milionë eurove. "NATO ka në plan të investojë 51 milionë euro për të modernizuar bazën ajrore të Kuçovës në Shqipëri. Paratë do të shkojnë drejt përmirësimit të infrastrukturës në bazë, përfshirë edhe depot e karburantit", tha z. Cazalet.

ashtu edhe si bazë kombëtare për Forcën Ajrore Shqiptare dhe investimi i NATO-s në Shqipëri do të sjellë një standard të ri për Forcat e Armatosura dhe investime për zonën e Kuçovës.



Reagimi

SALI BERISHA
Ish-kryeministri përshëndeti dje deklaratën e zëdhënësit të NATO-s, Piers Cazalet se financimi i bazës ajrore në Kuçovë është pjesë e Programit të Investimit të Sigurisë. "Me këtë rast shpreh kënaqësinë time dhe falënderoj Aleançën për vendimin e marrë, sikundër mbështes ofrimin nga Shqipëria të çdo lloj lehtësie dhe kontributi për Aleançën në përmirësimin e misionit të saj të paqes dhe sigurisë në Europë dhe në botë", tha z. Berisha.

"Të ndalet presioni, po monitorojmë procesin"

ONM: S'do tolerojmë asnjë presion dhe influencë ndaj procesit të vetingut



ar punën e institucioneve të vetingut nuk do të tolerohen", shprehet ONM. Ky operacion nuk ka funksion ekzekutiv mbi vendimmarrjen e komisionerëve të vetingut, por vetëm rol këshillues. Dy kanë qenë rastet kryesore kur është rekomanduar apelimi i vendimeve të vetingut. ONM nuk ka mbështetur konfirmimin

SHKARKIMET
"Vëzhguesit ndërkombëtarë të ONM-së analizojnë çdo dosje të vetingut. Kur në këndvështrimin dhe opinionin e tyre ekziston nevoja për të apeluar raste të caktuara, ata do t'i rekomandojnë Komisionerit Publik për ta bërë një gjë të tillë, ashtu siç ka ndodhur", deklaroi ONM.

në detyrë të kreu të Gjykatës Kushtetuese, Bashkim Dedja dhe atij të Gjykatës së Lartë, Xhezaïr Zaganjori. "ONM i ka rekomanduar Komisionerit Publik të apelojë kundër vendimit që konfirmoi në detyrë kreun e Gjykatës Kushtetuese. Komisioneri Publik ka ndjekur këtë rekomandim dhe ka dorëzuar apelimin për

këtë rast. Baza për këtë rekomandim nga ana e vëzhguesve ndërkombëtarë shtrihet në faktin se ONM nuk është dakord me arsyetimin dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për këtë rast. Më 6 gusht 2018 u rekomandua apelimi mbi të njëjtat baza për rastin e kreu të Gjykatës së Lartë, i cili u konfirmua në detyrë me vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit më 24 korrik 2018. Është përsëri në të drejtën e Komisionerit Publik të vendosë ose jo të ndjekë këtë rekomandim", thuhet në reagimin e ONM. Të pyetur mbi vendimet për shkarkimet e vëzhguesve të drejtësisë, vëzhguesit ndërkombëtarë theksojnë se procesi po monitorohet me kujdes.

Baza ajrore e NATO-s në Kuçovë alarmon Rusinë, Medvedev: Nuk do rrimë këmbëkryq

Kryeministri rus, Dimitri Medvedev paralajmëroi dje se Rusia nuk do qëndrojë këmbëkryq përballë këtyre zhvillimeve të perëndimit. Moskë është shqetësuar me shpalljen e forcimit e pozitës së NATO-s në Ballkan, ku si moment kulmor është marrja e bazës ajrore të Kuçovës, për ta shndërruar në bazë të saj rajonale për operacionet ushtarake të Aleançës së Atlantikut të Veriut. Shqetësimi konfirmohet edhe nga një shkrim në Sputnik këtë të martë. "Ushtria perëndimore në kufi", është titulli i shkrimit, ku analisti ushtarak rus Sergei Jermakov i referohet rastit të Kuçovës, ndërtimit pra aty të bazës ajrore rajonale, pse jo më të rëndësishmen për NATO-n. "Në samitin e fundit, vendet e NATO-s ranë dakord të rrisin potencialin ushtarak. Pastaj ranë dakord për forcimin e komponentit ushtarak në kufijtë jugorë të NATO-s.



Ekskluzive/Raporteri për Shqipërinë: Keqardhje që nuk pati marrëveshje për magistraturën

Fleckenstein: Dialog PS-PD, nuk mund të menaxhojmë çdo mosmarrëveshje në Shqipëri

"Opozita të gjejë rrugën e duhur për të kundërshtuar parregullsitë"

Darina Tanushi

Raporteri për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Knut Fleckenstein u ka bërë dje thirrje opozitës dhe maxhorancës në Shqipëri të gjejë gjuhën e dialogut. Edhe pse me pushimet e verës, Fleckenstein dha këtë intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare". "Në përgjithësi, dialogu dhe bashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe opozitës janë shumë të rëndësishme për përparimin në reforma dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së shqiptarëve të zakonshëm. Nëse ka pasur parregullsi, unë jam i sigurt se opozita do të gjejë mënyrën e duhur për të kërkuar rekurs", u shpreh raporteri. Fleckenstein parashikon të vijë në Tiranë para fundit të nëntorit, ndërkohë që shpreh keqardhje sa u përket mosdakordësisë së palëve në seancën e fundit të Parlamentit shqiptar për ndryshimet ligjore për rekrutimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj në Shkollën e Magistraturës. "Kjo është absolutisht e nevojshme për funksionimin e institucioneve. Shpresojmë se kjo do të bëhet së shpejti", shprehet Fleckenstein në këtë intervistë për "Gazeta Shqiptare". Sa i përket procesit të vetingut, raporteri për Shqipërinë në Parlamentin Evropian u shpreh se Shqipëria duhet të jetë krenare për këtë reformë shumë ambicioze. "Vetingu është thelbësor për të krijuar besim në këto institucione dhe sundimin e ligjit. Në fund të fundit, prova përfundimtare e një reforme të suksesshme duhet të jetë në rezultatet e arritura në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë edhe ndjekjen penale të efektshme dhe dënimet për krimin e organizuar. Fakti që tashmë ka pasur disa shkarkime dhe dorëheqje vullnetare tregon se vetingu po funksionon", deklaroi Knut Fleckenstein. Sa i përket datës së përcaktuar nga Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të Bashkimit Evropian për çeljen e negociatave me Shqipërinë, Fleckenstein shprehet se do të dëshironte që ajo datë të ishte më afër. "Unë besoj plotësisht se Shqipëria e meriton këtë në dritën e përpjekjeve që janë bërë në vend. Megjithatë, ajo që është e rëndësishme



Raporteri për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Knut Fleckenstein

ÇELJA E NEGOCIATAVE

"Do të kisha preferuar nëse fillimi do të ishte më shpejt se sa është parashikuar tani. Unë besoj plotësisht se Shqipëria e meriton këtë në dritën e përpjekjeve që janë bërë në vend. Megjithatë, e rëndësishme është se tani ekziston një rrugë e qartë për hapjen e negociatave, me një afat kohor transparent dhe hapat e ardhshëm që duhen ndërmarrë", tha Fleckenstein.

VETINGU

"Unë mendoj se Shqipëria mund të jetë krenare me reformën shumë ambicioze të drejtësisë që po zhvillohet. Por kjo është një maratonë, jo një sprint. Vetingu është thelbësor për të krijuar besim në këto institucione dhe sundimin e ligjit", deklaroi në intervistën ekskluzive, Knut Fleckenstein.



REFUGJATËT

I pyetur nëse pritja e refugjatëve nga Siria ishte një kusht për çeljen e negociatave me Shqipërinë, raporteri Fleckenstein u shpreh: "Jo. Kushtet për zgjerimin e BE-së janë të qarta, të njohura publikisht dhe duhet të zbatohen për të gjithë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë. Refugjatët sirianë nuk janë pjesë e kësaj".



KLIMA POLITIKE

"Ne nuk duhet të mikromenaxhojmë çdo çështje të mosmarrëveshjeve brenda Shqipërisë nga brenda Parlamentit Evropian. Ajo që është e rëndësishme për ne është që rregullat e zbatueshme, përfshirë ato që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri janë ndjekur. Në përgjithësi, dialogu dhe bashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe opozitës janë shumë të rëndësishme për përparimin në reforma dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së shqiptarëve të zakonshëm", tha dje raporteri.

është se tani ekziston një rrugë e qartë për hapjen e negociatave me një afat kohor transparent dhe hapat e ardhshëm që duhen ndërmarrë. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se puna përgatitore për negociatat, i ashtuquajtur i "screening", tashmë është duke u zhvilluar. Ky proces do të duhet të ndodhte gjithsesi, edhe nëse vendimi para verës do të ishte ndryshe", u shpreh raporteri i PE-së.

INTERVISTA

Zoti Fleckenstein, çfarë do të ndodhë brenda këtij viti, deri në qershor 2019 me Shqipërinë? Çfarë duhet të arrijë qeveria shqiptare në 11 muajt e ardhshëm?

Mendoj se prioriteti i parë që duhet të jetë është të qenit gatë për fillimin e duhur të negociatave të pranimit në BE vitin e ardhshëm. Kjo është një detyrë shumë e rëndësishme që kërkon shumë përgatitje administrative, si dhe vullnet politik. Në të njëjtën kohë, procesi i reformave duhet të vazhdojë me të njëjtin progres të qëndrueshëm që ne kemi vëzhguar dhe njohur në vitet e fundit. Kjo vlen veçanërisht për pesë fushat prioritare në reformën e ad-

ministratës publike, reformën e gjyqësorit, të drejtat e njeriut, luftën kundër korrupsionit dhe luftën kundër krimit të organizuar.

BE vendosi disa kushte për qeverinë shqiptare për hapjen e negociatave, përpara qershorit 2018, por negociatat nuk u hapën më 28 qershor. Si e vlerësoni këtë?

Do të kisha preferuar nëse fillimi do të ishte më shpejt se sa është parashikuar tani. Unë besoj plotësisht se Shqipëria e meriton këtë në dritën e përpjekjeve që janë bërë në vend. Megjithatë, ajo që është e rëndësishme është se tani ekziston një rrugë e qartë për hapjen e negociatave, me një afat kohor transparent dhe hapat e ardhshëm që duhen ndërmarrë. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se puna përgatitore për negociatat, i ashtuquajtur i "screening", tashmë është duke u zhvilluar. Ky proces do të duhet të ndodhte gjithsesi, edhe nëse vendimi para verës do të ishte ndryshe. Tani duhet të sigurohemi në të dyja anët që ta përdorim këtë kohë për të përgatitur dhe vendosur negociatat e pranimit në një fillim të mirë vitin e ardhshëm pa asnjë humbje kohe.

A ka pasur ndonjë kusht "të fshehur", për shembull pranimi i refugjatëve nga Siria, që sollti këtë shtyrje të hapjes së negociatave?

Jo. Kushtet për zgjerimin e BE-së janë të qarta, të njohura publikisht dhe duhet të zbatohen për të gjithë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë. Refugjatët sirianë nuk janë pjesë e kësaj.

A do të kenë një vizitë në Tiranë së shpejti?

Shpresoj shumë të ndodhë. Fokusi im në muajt e ardhshëm do të jetë në punën brenda Parlamentit Evropian si raportues përgjegjës për raportin e progresit për Shqipërinë dhe legjislacionin, që krijon instrumentin e ri financiar për të ndihmuar vendet në rrugën drejt pranimit në BE përtej 2020-ës. Por unë sigurisht parashikoj të vij së shpejti në Tiranë, përpara fundit të nëntorit.

Seanca parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë u mbyll pa konsensus, ndërkohë që pati një debat të ashpër mbi një çështje që lidhej me ndërtimin e një teatri të ri. A e kenë ndjekur këtë debat dhe çfarë do të rrjedhë nga kësaj?

Ne nuk duhet të mikromenaxhojmë çdo çështje të mosmarrëveshjeve brenda Shqipërisë nga brenda Parlamentit Evropian. Ajo që është e rëndësishme për ne është që rregullat e zbatueshme, përfshirë ato që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri janë ndjekur. Në përgjithësi, dialogu dhe bashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe opozitës janë shumë të rëndësishme për përparimin në re-

forma dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së shqiptarëve të zakonshëm. Nëse ka pasur parregullsi, unë jam i sigurt se opozita do të gjejë mënyrën e duhur për të kërkuar rekurs.

Ditët e fundit ka pasur largime të disa gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkak të procesit të vetingut. Si e vlerësoni këtë proces, ndërkohë që disa institucione të larta ligjore, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese kanë vakanca dhe rrjedhimisht nuk mund të funksionojnë?

Unë mendoj se Shqipëria mund të jetë krenare me reformën shumë ambicioze të drejtësisë që po zhvillohet. Por kjo është një maratonë, jo një sprint. Vetingu është thelbësor për të krijuar besim në këto institucione dhe sundimin e ligjit. Në fund të fundit, prova përfundimtare e një reforme të suksesshme duhet të jetë në rezultatet e arritura në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë edhe ndjekjen penale të efektshme dhe dënimet për krimin e organizuar.

Fakti që tashmë ka pasur disa shkarkime dhe dorëheqje vullnetare tregon se vetingu po funksionon. Megjithatë, është për të ardhur keq që nuk ka pasur një marrëveshje ndërmjet partive politike për ndryshimet e nevojshme ligjore për rekrutimin dhe trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj, me një kapacitet më të lartë në shkollën e magistraturës. Kjo është absolutisht e nevojshme për funksionimin e institucioneve. Shpresojmë se kjo do të bëhet së shpejti.

KORRUPSIONI AKUZAT

Shehaj zbardh skemën: Biznesmeni mori dhuratë 178 mln euro dhe 2 licenca ekskluzive

PD: Do kthejmë paratë e vjedhura, anulojmë çdo koncesion korruptiv

"PPP dëmtuan me 3.7 mln euro buxhetin e shtetit"

Valentina Madani

Opozita akuzon max horancën se skema korruptive e koncesioneve dhe e Partneritetit Publik Privat ka dëmtuar buxhetin e shtetit me 3.7 miliardë euro. Pas ardhjes në pushtet, demokratët paralajmërojnë se do të anuljnë të gjitha koncesionet dhe prokurimet korruptive përmes amendimit të ligjit, me qëllim sigurimin e konkurrencës së lirë. Deputeti Agron Shehaj dhe drejtoresha e Departamentit për Antikorruptionin, Lealba Pelniku deklaruan dje se dëmi i shkaktuar në buxhetin e shtetit si pasojë e skemës korruptive të përdorur nga kryeministri Rama ka arritur në 3.7 miliardë lekë. Shehaj tha se nga ky veprim çdo njëres prej familjeve shqiptare i është vjedhur mesatarisht 5 mijë euro. Shehaj shprehet se Rama ka lidhur partneritet me biznesmenë të korruptuar. Gjithashtu, Shehaj tha se biznesmeni Klodjan Zoto përfiton si dhuratë pa asnjë meritë a kapacitet, 178 mln euro dhe 2 licenca ekskluzive, ndërkohë që çdonjërës prej 800 mijë familjeve shqiptare i është vjedhur mesatarisht 5 mijë euro. Shehaj premtoi se me ardhjen e PD-së në pushtet, të gjitha kontratat abuzive do të rishikohen. "Anulimi i të gjitha koncesioneve korruptive do të jetë akti i parë që Partia Demokratike do të bëjë kur të marrë votëbesimin e shqiptarëve. Pak rëndësi ka se në cilën zyrë avokatie perëndimore janë bërë, nuk mundet që një popull dhe një shtet të mbahen peng nga një grup politikanesh kusarë dhe oligarkë të përlyer", deklaroi z. Shehaj. Sipas Shehajit, investitorët e huaj largohen nga Shqipëria pasi po favorizohen vetëm bizneset pranë kryeministrit Rama. Po ashtu, ai tha se nuk bëhet Shqipëria me politikanë të pandershëm, ndërsa shtoi se sapo të vijë PD në pushtet, do të anulohet koncesionet që janë bërë nga kjo qeveri. "Kjo qeveri nuk për-



AKUZA

"Shteti i ka të gjitha instrumentet e nevojshme të mbrojtë interesat e qytetarëve, mjafton vullneti dhe në e kemi vullnetin dhe vendosmërinë e duhur që paratë e PPP-ve korruptive t'ia marrim Nushit, Zotos, Ramës, Ahmetajt, Gjikhurit etj. dhe t'ua kthejmë qytetarëve", deklaroi deputeti i PD-së.

Raporti i qeverisë për rrugët, LSI akuza Ramës

Vasili: 10 km të shkreta damlla, shqiptarët ta mbledhin mendjen

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili reagoi dje me ironi pas shifrave të fundit që tregojnë se në periudhën janar-prill qeveria ka ndërtuar 2.3 km rrugë, ose thënë ndryshe 10 km në vit. Vasili komentoi dje të dhënat e publikuara nga Ministria e Financave, ku për periudhën janar-prill, qeveria ka ndërtuar 2.3 km rrugë. Përmes një statusi në "Facebook", Vasili me ironi shkruan se qeveria ka ndërtuar vetëm 10 km rrugë në vit, ndërsa e cilëson Ramën "kineast". "Megjithatë, 10 km të shkreta damlla mbeten dhe aq", shkruan Vasili. "Kryeministër i lodhur dhe shifrat turpëruese të rrugëve. Janar-prill qeveria ka ndërtuar 2.3 km rrugë ose thënë ndryshe 10 km në vit. Për një kryeministër të



lodhur dhe kineast si ky, 10 km në vit janë shumë, shumë, shumë... Do dëgjoni edhe që janë 10 km kaq të bukura, me një standard kaq të lartë, kaq të mrekullueshme, sa që nuk i kenë parë kurrë në jetë dhe asgjëkundi në botë. Janë rrugët e rilindjes o miq, s'ka të dyta si ato. Megjithatë, 10 km të shkreta damlla mbeten dhe aq. Në fund të

IRONIA

Kreu i deputetëve të LSI-së, Petrit Vasili shkruan: "Shqiptarët ta mbledhin mendjen, me këtë kryeministër kineast, filma me rrugë do shohin sa do ngopen, por rrugë të vërteta hiç".

vitit do bëjë kryeministër edhe 10 km film apo video dhe do ngopet duke i parë si fëmijët video game-t. Shqiptarët ta mbledhin mendjen, me këtë kryeministër kineast, filma me rrugë do shohin sa do ngopen, por rrugë të vërteta hiç. Ps. Shifrat e rrugëve janë të vetë qeverisë së kinemasit", shprehet z. Vasili.


dor tenderat për të ndërtuar infrastrukturën, për partneritet, pasi thela bëhet më e madhe. Nga 200 partneritetet që ka bërë qeveria 'Rama', nuk janë bërë me kompani europiane, pasi vetëm ata i sjellin një pjesë të parave Ramës. Çfarë marrëveshjeje partneriteti ka Rama me Vilma Manushin? Sa i kthen qeverisë? Nuk

bëhet Shqipëria me ministra të etur për pushtet. Anulimi i koncesioneve do të jetë hapi i parë që do të marrë PD kur të vijë në pushtet. Do jetë detyra jonë parësore që të ndalojmë këtë vjedhje. Askush nuk duhet të mendojë se mund të vjedhë shqiptarët se kontratat e PPP-ve korruptive. Shteti i ka të gjitha instrumentet e



MASA

"Anulimi i të gjitha koncesioneve korruptive do të jetë akti i parë që Partia Demokratike do të bëjë kur të marrë votëbesimin e shqiptarëve. Pak rëndësi ka se në cilën zyrë avokatie perëndimore janë bërë, nuk mundet që një popull dhe një shtet të mbahen peng nga një grup politikanesh kusarë dhe oligarkë të përlyer"



Nëna e dëshpëruar, letër Berishës: Kreu i PS Elbasan më prostituii vajzën

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje denoncimin e një nëne nga Elbasani, e cila akuzon direkt kreun e PS në lagjen "Visarion Xhuvani" se i ka marrë vajzën për ta bërë prostitutë. "I ndëruar zoti Berisha, duke qenë se je zëri i fuqishëm, doja të denoncoja Durim Koçin, kryetari i PS-së për lagjen 'Visarion Xhuvani', Elbasan. Unë që po ju shkruaj jam një nënë, që prej 8 muajsh ky maskara ka marrë vajzën time bashkë me dy shoqet e saj për prostituta në Gjermani", - shkruan gruaja në letrën që i ka nisur Berishës. Ajo informon ish-kryeministrin: "Kam denoncuar dhe në Policinë e Elbasanit, por nuk kam marrë asnjë përgjigje. Ju lutem z. Berisha, publikojeni këtë, por anonim të lutem. Ky ka edhe një lokal, i cili quhet 'Atlas', në të cilin shpërndahet drogë dhe aty kam parë shumë djem, të cilët pinë hashash dhe shpërndajnë. Jam me shpresa që vajza ime të kthehet në shtëpi bashkë me shoqet e saj dhe ky bastard meriton burgun".

i është vjedhur mesatarisht 5 mijë euro. "Rama partneritetet i bën vetëm me disa oligarkë shqiptare, vetëm ata që pranojnë të bëhen partner biznesi me Ramën mund të fitojnë një koncesion. Sepse vetëm ata i kthejnë Ramës një pjesë së parave, që i duhen për të konsoliduar pushtetin e tij absolut. Çfarë marrëveshjeje partneriteti ka

Rama me Vilma Nushin? Nga 100 milionë euro sa i kthen qeverisë? Po për sa u takon inceneratorëve, nga 200 milionë euro, sa merr Zoto dhe sa Ahmetajt? Po nga 400 milionë euro të Rrugës së Kombit? Sa do marrin? Projekti 1 miliard është shumë i mirë për Ramën dhe partnerët e tij, por jo për shqiptarët", theksoi deputeti i PD-së.



Sondazhi "Eurobarometër 2018", publikuar nga Komisioni Europian tregon se mbi 50% e shqiptarëve vlerësojnë se situata financiare e familjeve të tyre dhe punësimi janë përmirësuar, krahasuar me katër vite më parë. Sondazhi bazohet në intervista të drejtpërdrejta me qytetarët. Në Shqipëri janë realizuar 1048 të tilla. Pyetjes së si e vlerësojnë situatën financiare të familjes së tyre, 62% e të intervistuarve në Shqipëri e vlerësojnë "pozitivisht". Krahasuar me vitin 2014, kur është realizuar për herë të parë ky sondazh në Shqipëri, përqindja e atyre që vlerësojnë se gjendja e financiare e familjes së tyre është "pozitive" është rritur nga 52.9%, në 61.9%. Sa i takon situatës personale të punë-

"Eurobarometër 2018", situata ekonomike dhe punësimi

Mbi 50% e të intervistuarve në Shqipëri e vlerësojnë të përmirësuar



SITUATA FINANCIARE

Sondazhi bazohet në intervista të drejtpërdrejta me qytetarët. Në Shqipëri janë realizuar 1048 të tilla. Pyetjes së si e vlerësojnë situatën financiare të familjes së tyre, 62% e të intervistuarve në Shqipëri e vlerësojnë "pozitivisht". Krahasuar me vitin 2014, kur është realizuar për herë të parë ky sondazh në Shqipëri, përqindja e atyre që vlerësojnë se gjendja e financiare e familjes së tyre është "pozitive" është rritur nga 52.9%, në 61.9%.

simit, 57% e të intervistuarve e vlerësojnë "pozitive". Sentimenti për gjendjen ekonomike ka ardhur gradualisht në përmirësim përgjatë kohës që është aplikuar 'Barometri' në Shqipëri. Pje-

sa e të intervistuarve që shprehen se gjendja e ekonomisë së vendit është "shumë keq" është ulur nga 35.5% në sondazhin e parë të vitit 2014 në 7.44% në sondazhin e fundit, ndërsa

ata që e konsiderojnë gjendjen e ekonomisë si "pozitive" ka kaluar nga 27.6% në 48.8%. Të pyetur mbi pritshmëritë e tyre për 12 muajt e ardhshëm, 84% e të intervistuarve në Shqipëri e vlerë-

sojnë situatën "më mirë" ose "njësore". Në Bashkimin Europian, vetëm 25% presin përmirësim, ndërsa 48% mendojnë se situata do të mbetet e njëjtë. Pritshmëritë për 12 muajt e ardhshëm mbeten pozitive për situatën ekonomike dhe punësimin, në mbi 50% të të intervistuarve. Konkretisht, 50% e të intervistuarve në Shqipëri vlerësojnë se punësimi do të përmirësohet përgjatë vitit të ardhshëm. Në Bashkimin Europian, kjo shifër është vetëm 27%. Qytetarët shqiptarë shprehin optimistë edhe mbi situatën personale të punësimin, ku 49% e të intervistuarve besojnë se do të ketë përmirësim dhe 35% mendojnë se do të vijojë e njëjtë. Në total, 84% e të intervistuarve janë pozitivë.

Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën janar-qershor për vitin 2018

Qeveria, 104.4 milionë euro dëm buxhetit në 6 muaj

Në sektorin e tatim-taksave, dëmi është 146 milionë lekë

Ornela Manjani

K eqmenaxhimi i financave publike, i ka shkaktuar një kosto prej rreth 104.4 milionë euro buxhetit të shtetit në gjashtë muajt e parë të këtij viti. Institucionet shtetërore dhe njësitë e qeverisjes lokale e qendrore kanë shkaktuar një dëm ekonomik prej mbi 100 milionë euro. Shifrat bëhen të ditura në buletin dhe dytë statistikor të vitit 2018, i cili përmbledh rezultatet e të gjitha auditimeve të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në periudhën janar-qershor 2018. Kontrolli i Lartë i Shtetit thotë në raport se nga auditimet gjatë kësaj periudhe janë konstatuar parregullsi dhe shkelje financiare në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej 3,868,623 mijë lekë ose 30.8 milionë euro. Sipas raportit, janë gjetur shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej 9,240,178 mijë lekë, afërsisht 73.6 milionë euro nga e cila: 2,777,894 mijë lekë në fushën e të ardhurave, afërsisht 22.1 milionë euro dhe 6,462,284 mijë lekë afërsisht 51.5 milionë euro, në fushën e shpenzimeve jo me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve. Në total janë konstatuar shkelje në shumën



13,108,801 mijë lekë ose afërsisht 104.4 milionë euro. Në shkeljet me dëm ekonomik (shpenzimet), në fushën e pagave, shpërblimeve dhe sigurimeve shoqërore, dëmi arrin në vlerën e përgjithshme prej 21,966 mijë lekë, ku pjesa më e madhe i përket Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar, në vlerën 19,367 mijë lekë. Në raport mësohet se në fushën e prokurimeve, shkeljet ishin në vlerën e përgjithshme prej 520,835 mijë lekë, ku shkeljet më të mëdha ishin në Bashkitë Këlcyrë dhe Vlorë, me përkatësisht 37.4

dhe 29.3 milionë lekë. Ndërkohë në zërin "Të tjera", shkelje të disiplinës financiare, dëmi ishte në shumën e përgjithshme prej 167,741 mijë lekë, ku dëmi më të lartë e ka Fondi i Sigurimit të Kujdesit të Detyrueshëm Shëndetësor, në vlerën 156,969 mijë lekë, nga të cilat: 132,465 mijë lekë, si pasojë e likuidimeve më tepër nga mos reflektimi i çmimeve të ulura të barnave në kundërshtim me pikën nr.7 të VKM nr.380 datë 25.05.2016; 23,453 mijë lekë, si pasojë e mos përfshirjes së vlerës për 2045

SHKELJET

- 1.Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej 3.8 milionë lekë.
- 2.Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej 9.2 milionë lekë, afërsisht 73.6 milionë euro nga e cila: 2.7 milionë lekë në fushën e të ardhurave, afërsisht 22.1 milionë euro dhe 6.4 milionë lekë afërsisht 51.5 milionë euro, në fushën e shpenzimeve jo me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve. Në total janë konstatuar shkelje në shumën 13.1 miliardë ose afërsisht 104.4 milionë euro.
3. Në fushën e prokurimeve, shkeljet ishin në vlerën e përgjithshme prej 520.8 milionë lekë, ku shkeljet më të mëdha ishin në Bashkitë Këlcyrë dhe Vlorë, me përkatësisht 37.4 dhe 29.3 milionë lekë.
4. Në sektorin e tatim-taksave, dëmi është në vlerën e përgjithshme prej 146.6 milionë lekë, ku nivelin më të lartë e ka OSHEE në vlerën 38.2 milionë lekë, si pasojë e mos regjistrimit të përfaqësuesit tatimor si dhe faturimit të TVSH-së me autofaturë ka sjellë shmangien e tatimit në burim për subjektin "X...AG".
5. Në sektorin e doganave, dëmi është në vlerën e përgjithshme prej 591.3 milionë lekë.

seancave dializë për pacientë të cilët tejkalonin 13 seanca/muaj përfituar pa drejtësisht prej 2 spitaleve private "H.S" dhe "A.S"; 825 mijë lekë, si pasojë e pagesave të barnave me formë-dovë mbi përcaktimet në Listën e Barnave të Rimbursueshme (LBR); 226 mijë lekë, si pasojë e penaliteteve të pazbatuara për furnitorin për shkelje të afatit të lëvimit të mallrave. Në sektorin e Tatim - Taksave, dëmi është në vlerën e përgjithshme prej 146,687 mijë lekë, ku nivelin më të lartë e ka OSHEE në vlerën

38,245 mijë lekë, si pasojë e mos regjistrimit të përfaqësuesit tatimor si dhe faturimit të TVSH-së me autofaturë ka sjellë shmangien e tatimit në burim për subjektin "X...AG".

DOGANAT

Në sektorin e doganave, dëmi është në vlerën e përgjithshme prej 591,350 mijë lekë. Në fushën e shitjes, blerjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore, në shumën e përgjithshme prej 2,113,750 mijë lekë. Dëmi më të lartë e ka KESH sh.a, në vlerën 1,582,301 mijë lekë, si pasojë

e miratimit nga bordi i ERE vendimin për marrëveshjen me shoqërinë "OST" për shërbimet ndihmëse dhe balancim të sistemit elektro-energetik dhe me një diferencë të madhe midis çmimit të shitjes së energjisë nga Shoqëria "KESH" sh.a kompanive E..., G..., A... dhe G... me çmimin e blerjes së energjisë nga shoqëria "OSHEE" sh.a nga këto kompani (KLSH nuk i bën emrat e kompanive publike). Në zërin "Të tjera", shkelje të disiplinës financiare, dëmi është në shumën e përgjithshme prej 287,069 mijë lekë. KLSH thekson se ka zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare me dëm ekonomik në të ardhurat dhe shpenzime, në shumën totale prej 3,868,623 mijë lekë, nga e cila ka rekomanduar për shpërbim dëmi shumën 3,482,319 mijë lekë. KLSH ka konstatuar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në fushën e të ardhurave, me dëm 2.8 mld lekë. Dëmi më i lartë është nga Bashkia Kamëz, në vlerën 487,395 mijë lekë, si pasojë e mos fillimit të procedurave të nevojshme ligjore për kthimin e vendimeve të gjyqare në tituj ekzekutiv nëpërmjet gjykatës dhe për pasojë mos arkitimit në Buxhet të këtyre vlerave. Për shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në fushën e shpenzimeve, dëmi ishte 6.4 mld lekë.

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon vendimet për dy vite, ja kush përfiton

Dosjet 2013-2014, lista me pronarët që marrin paratë

Pronarët, gjashtë muaj kohë për të plotësuar dokumentet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me pronarët që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 2013 dhe 2014, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilin dosje. Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon formularin dhe dokumentet që duhet të plotësojnë përfituesit në të gjithë vendin për të marrë kompensimin në para ose kompensim fizik.

KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK

Sipas formularëve-tip, mësohet se kërkuesi duhet të cilësojë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës, vërtetim nga gjykata nëse vendimi përfundimtar i vlerësimit të tij është ankmuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndryshuar rrethi i trashëgimitarëve,



prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimitarët, vërtetim numër llogarie, vërtetim nëse subjekti ka përfituar ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat do-

kumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

LLOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit

1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë

të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuar financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompensohet fizikisht, nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave thotë se subjektet e shpronësuara u nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

SHKURTE

Tatimet u bllokojnë pasuritë 20.612 bizneseve

Qershori i këtij viti ka shënuar një shifër rekord të bizneseve, të cilave u është vendosur masa e barës siguruese apo hipotekore nga ana e administratës tatimore. Sipas të dhënave zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në qershor rezultojnë 20.612 biznese nën regjimin e bllokimit të pasurive të luajtshme e të paluajtshme. Ajo ka bërë publike listën 20 mijë tatimpaguesve me detyrime të papaguara në afat, ndaj të cilëve ka vendosur marrjen e masave të sigurimit mbi ta gjithë pasuritë për ekzekutimin e detyrimeve dhe se ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të tyre. Vendosja e barës siguruese apo hipotekore është një prej formave të mbledhjes me forcë të borxhit nga ana e administratës tatimore. Bizneset e publikuara në listën e Tatimeve nuk mund të kryejnë asnjë transakcion me pasuritë e tyre deri në shlyerjen e detyrimit tatimor. Vetë Administrata Tatimore sqaron se publikimi i listës bëhet në mënyrë që organet apo institucionet, të cilat kanë bërë regjistrime të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të tatimpaguesve debitorë, të regjistrojnë detyrimin tatimor të papaguar si barrë mbi këtë pasuri dhe të mos lejojnë kryerjen e transakcioneve për transferimin e pasurive të tatimpaguesve debitorë deri në momentin që detyrimi tatimor i papaguar të arkëtohet.

Qeveria kursen 5 milionë euro nga fondet e ndihmës ekonomike

Në gjashtëmuorin e parë të vitit, qeveria ka kursyer 654 milionë lekë (5 milionë euro) nga fondet e programuara të ndihmës ekonomike. Sipas të dhënave nga Ministria e Financave, ishin parashikuar për t'u shpenzuar 9,9 miliardë lekë si ndihmë ekonomike për familjet në nevojë, por në fakt janë disbursuar 9,3 miliardë lekë. Kjo shumë ishte 6,6% më e ulët se plani i periudhës dhe 3.3 për qind më e ulët se fakti i një viti më parë. Sipas shpjegimeve zyrtare, ulja e shpenzimeve buxhetore në këtë zë erdhi për shkak të reformimit të skemës së ndihmës. Familjet dhe individët që përfitojnë ndihmën selektohen sipas një formule të re pikëzimi, e cila hyri në fuqi këtë vit. Reforma synon që ndihma ekonomike të përfitohet nga 10 për qind e popullsisë në ekstremin e poshtëm të varfërisë. Deri me 2016 ishin të përfshira 180 mijë familje në skemë, por me aplikimin e skemës së re, numri i tyre do të jetë shumë më i ulët. Aplikimi i saj ngjalli debate, pasi shumë familje edhe pse në nevojë ekstreme, u përjashtuan nga ndihma shtetërore.

PRONARËT QË MARRIN PARATË

Nr. Rendor	Nr/ Dosje	Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
1	504	Tiranë	Halit Cara	473,661
2	447	Gjrokastër	Vullnet Kallajxhi	502,704
3	54	Korçë	IVANI FABERI	35,490
4	255	Shkodër	Carla Meschini	51,336,600
5	158	Berat	Ilia Therecka	
6	380	Shkodër	Lutfi Bala	485,127
7	533	Tiranë	SHADIJE LIÇI	
8	161	Elbasan	ERVIN GJATA	-1,748,067
9	249	Korçë	Jashar Hysenbegasi, Sabri Hysenbegasi	
10	750	Shkodër	Fatbardhe Hefovia	3,659,730
11	610	Tiranë	AV.MAKSIM GJOKUTAJ	-2,978,250
12	171	Shkodër	Mark Dedushi	793,800
13	1474	Shkodër	Mark Kol Doda	585,000
14	1723	Tiranë	LORETA DERVISHI	11,719,575
15	531	Lezhë	Fran Tanushi	690,780
16	245	Tiranë	SELMAN HYSENAGOLLI	
17	533	Tiranë	ALI ZELA	
18	598	Tiranë	PETRIT SHEHU	2,417,210
19	137	Berat	Destimona Tartari (Zhiti)	6,699,000
20	161	Elbasan	Fete Disha	314,318
21	87	Gjrokastër	Fiqiri Fagu	
22	384	Tiranë	RUKIE JARECI	633,318
23	59	Elbasan	KUJTIM GJEVORRI	
24	1-Sep	Kukës	Avni Rexh Petku	
25	417	Vlorë	Lumturi Papingji	398,000
26	702	Vlorë	Mimin Mustafaraj	13,708,800
27	1057	Kukës	Tahir Imer Cenaj	-29,951,513

VENDIMET STRASBURGU

Dosjet që fitojnë kompensimin nga Gjykata Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut

Ornela Manjani

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut u ka njohur të drejtën për kompensimin e pronave 111 pronarëve, në një vlerë totale prej rreth 4 miliardë lekësh. Vendimet janë botuar në Fletoren Zyrtare, ku jepet vlerësimi i 89 dosjeve (111 pronarëve), të cilët janë drejtuar Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për të fituar të drejtën e kthimit a kompensimit. Në fakt, vlerësimi që bën Agjencia për këto dosje vjen në vazhden e përmbylljes së 26 mijë kërkesave, sipas së drejtës që jep ligji në fuqi, ndërkohë që nuk dihet nëse pronarët do të vijnë ta ndjekin çështjen në Strasburg,

Strasburgu, 4 miliardë lekë për pronarët që ankimuan vendimet e ATP

Lista e plotë, përfituesit në të gjithë vendin

apo do të pranojnë vlerësimin e Agjencisë. Por, duhet theksuar se në shqyrtimet që ka bërë Agjencia për një pjesë të tyre nuk ka vendim kompensimi, pretendentë këta që konsiderohen me

mangësi në dosje dhe për një pjesë fatura financiare është paguar, pas vendimeve nga Strasburgu. Ndërkohë, pjesa tjetër, afro 70 emra, nëse pranojnë kompensimet nga Shqipëria, paratë që ata

do të ndajnë mes tyre kapin vlerën e 4 miliardë lekëve. Të paktën kjo është vlera totale e kompensimit, pa përfshirë këtu hallkat sekondare të ligjit, i cili fraksionon paratë në këmbim të tokave,

ose ul masën e kompensimit deri në 60 për qind, për hir të kompensimit të shpejtë.

DOSJET NË STRASBURG

Gjykata e të Drejtave të Njeriut në Strasburg është

duke shqyrtuar 103 çështje pronësie të qytetarëve shqiptarë dhe në rast se ato do të pranohen, atëherë qeveria shqiptare do duhet të paguajë një faturë të hidhur prej rreth 822 milionë eurosh.

DOSJET QË FITOJNË KOMPENSIMIN NGA GJYKATA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

DEMIRHAN SHENBITRAKU	KORCE	27.918	Trashegimtare HANMJA	Tirane	-	PRENG TOSKU	Mat	4,239,531
Ali Kosova	Durres	48,634,682	308,654,000			Evdhoksia Kosta	Gjirokaster	
HAXHI PICARI	Marqinet		AMIR HYKA	Tirane	38,172,330	Kujtim Myshketa	Durres	64,249,882
Demiran Sulejman Hasa	Korçe	49.636	Niko Nuke	Devoll		Hysni Mulleti	Tirane	-297,008,910
ALI ARBANA	TIRANË		Sofokli Eqimi	Korçe	907.001	Servete Kambo	Tirane	-57,371,081
ORHAN POJANI	Korçe	8,148,219	Refat Puto	Sarande		Nadire Jella	Tirane	20,291,607
MUHARREM GEGA	Gjirokaster		Arjan Puto	Sarande	-16,225,474	SELIM LULI	Tirane	1,456,896
Hysen Saraci	TIRANË	52,704,603	Vladimir Dume	Kolonje	-3,189,368	Ismail Risilia	Vlore	4,800,000
Shefikat Bylykbashi	ELBASAN	34,496,460	Agim Beshiri	Durres		Hajdije Derhemi	Tirane	-61,493,558
MYHEDIN LLAGAMI	TIRANË		Agim Beshiri	Durres	57,465,000	Bilal Hatibi (Jajaga)	Tirane	-31,413,655
FERIDE MAJUNIDURRES	9,668,000		Kaliopi Llazari	Tirane	25,347,767	AVNIETJ. FORTUZI	Tiranë	27,999,613
AFERDITA KASA	TIRANE		HAMID DEMNERI	Tirane	3,951,171	Ali Kosova	Durres	27,348,144
KOSTAQ SAHATCI	TIRANE	59,743,700	SHAHIN VRIONI	Tirane		YLLI DIBRA	Tirane	17,398,000
Ibrahim Dibra	Shkoder	-68,197,815	ORHAN POJANI	Tirane	59,743,700	FERIDE FRASHERI	Tirane	73,665,900
SHPRESA KERCANI	TIRANË	26,017,457	Nadire Jella	Tirane	27,865,801	SKENDER BYLYKU	Kamez	924.686
Sotir Kondi	Tirane		Selim Luli	Tirane		Faik Tomini	Kamez	4,200,530
Pasardhesit Tigani	Skelë		Selim Luli	Tirane	-81,157,175	Ali Kosova	Durres	6,300,096
Faik Tomini	Kamez		Grigor Rexho	Tirane	109,726,430	HAKI SHEHI	Tirane	15,232,000
Mit'hat Kellici	Tirane	29,533,329	Hysen Vrioni	Berat		Ervin Gjadri	Kruje	22,559,344
HAMID DEMNERI	Tirane	10,862,372	Murat Toto	Gjirokaster	-32,246,576	Ervin Gjadri	Kruje	22,200,000
SHPETIM FAGU	Tirane		Eftimia Koxhaj, Sterjo Koxhaj	Durres		Ervin Gjadri	Kruje	17,760,000
Hasan Myshketa	Rashbull	-1,881,715	Idhomen Kosturi	Durres		Egon Gjadri	Kruje	60,361,504
FATMIR ALLA	TIRANE	89,403,615	Jovan Stavri	Durres		VALERIA VRIONI	Tirane	56,053,053
VALERIA VRIONI	TIRANE		Hamid Demneri	Tirane	10,466,220	Syrja Pojani	Tirane	27,393,000
HYSEN E GEZIM PETRELA	TIRANE		Trashegimtare Kasa	Tirane	7,270,571	Filip Sota	Himare	4,651,200
5,893,272			Eqerem Maçi	Tirane	-300,828,000	Mehmet Kasmi	Kruje	31,680,000
Nadire Jella	Tirane	6,629,931	Josif Nishe	Korçe	111.78	Sulejman Kapedani	Durres	5,696,000
VIKTORIA, ANDON, RENO MELO	Tirane		LUAN KOTHERJA	ELBASAN	4,212,120	Sulejman Kapedani	Durrës	7,120,000
43,599,200			Hamza e Mustafa Kosova	Durres	755.054	Sulejman Kapedani	Durres	23,751,000
QEMAL KARAOSMANI	Tirane	37,665,900	Hamza e Mustafa Kosova	Durres		GEZIM SULSAROVA	Tirane	8,220,800
LIRI MACI	Tirane	5,702,238	Beqir Kollçiu	Durrës	362.661	Filip Sota	Himare	489.601
PETER CEPUNJA	Tirane	37,435,671	Hamza Kosova, Mustafa Kosova	Durres		Ervin Lelo	Vlore	2,937,600
Kaliopi Llazari	Tirane	82,974,591	42,575,762			Ali Kosova	Lushnje	
GJERGJ ASHTA	Tirane	63,396,999	SULEJMAN SRAFA	Tirane	15,210,000	ALBI PETRELA	Tiranë	1,419,743
Dashamir Luga	Durres		Shpati Dragoti	Durres		Refat, Puto	Sarandë	-473,325,500
Stavri Cale	Korçe	-49,925,250	Halil Din Kadria	Piste	468.709	BULENT TELA	Elbasan	-242,149,632
MYZEJEN MAÇI	Tirane		Sabri Jella	Maminas		SHPETIM DVORANI	Korçë	1,310,000
Trashegimtare HANMJA	Tirane	-	Hajdije Derhemi	Tirane	-26,251,842	ILIR SOPOTI	Tiranë	113,110,832
925,546,580			Sutki Nuhi Spahiu	Kukes	3,473,978			

Drejtori i Policisë Rrugore: Në shërbim 1078 punonjës policie, 90 aksidente më pak se në 2017-ën

Sezoni turistik, Mit'hat Tola: Policia, masa të larta për rritjen e sigurisë

"Gjatë 7-mujorit të parë të vitit 2018 janë arrestuar 1401 drejtues mjeti"

Ina Allkanjari

Gjatë 7-mujorit të parë të vitit 2018 nga të dhënat operative dhe zyrtare janë arrestuar 1401 drejtues mjeti gjithsej. Përveç ndëshkimeve administrative dhe penale, Policia Rrugore do të përdorë të gjithë instrumentet në dispozicion, me synim ndërgjegjësimin e një numri sa më të madh përdoruesish rrugorë për risqet e alkoolit në timon, si një nga vrasësit më të mëdhenj në rrugë në aksidente rrugore". Kështu është shprehur drejtori i Përgjithshëm i Policisë Rrugore, Mit'hat Tola, në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare".

Më tej, drejtori i Policisë Rrugore theksoi se me hyrjen e sezonit veror, duke filluar nga data 01 korrik 2018 janë angazhuar me shërbim 1078 punonjës policie, nga strukturat vendore të policisë të territorit dhe nga DVP-të e tjera, si dhe të reparteve të NSH. Në dispozicion të këtyre forcave janë 163 mjete. Gjithashtu Mit'hat Tola tregoi se në shkallë vendi ka një shtim të patrullimeve të strukturave të Policisë Rrugore në akset kryesore rrugore, me qëllim parandalimin e aksidenteve dhe ndëshkimit të shkelësve të rregullave të qarkullimit rrugor. Për sa i përket numrit të aksidenteve për 7-mujorin e fundit, Tola shprehet se kemi pakësim të aksidenteve me pasojë vdekjeje. "Duke krahasuar të dhënat statistike me 7-mujorin e parë të vitit 2017, deri në datën 31.07.2018 kanë ndodhur 90 aksidente më pak, 17 të vrarë më pak, 26 të plagosur më pak, 191 të plagosur lehtë më pak", u shpreh drejtori i Përgjithshëm i Policisë Rrugore, Mit'hat Tola.

Ju këni deklaruar se policia ka marrë masa shitesë për trafikun në sezonin e verës. Konkretisht çfarë masash janë marrë për të shmangur aksidentet?

Duke filluar nga data 01 korrik 2018, janë angazhuar me shërbim 1078 punonjës policie nga strukturat vendore të policisë të territorit dhe nga DVP-të e tjera, si dhe të reparteve të NSH. Në dispozicion të këtyre forcave janë 163 mjete. Gjithashtu, në shkallë vendi ka shtim të patrullimeve të strukturave të Policisë Rrugore në akset kryesore rrugore, me qëllim parandalimin e aksidenteve dhe ndëshkimit të shkelësve të rregullave të qarkullimit rrugor. Grupi i Drejtimit dhe i Koordinimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ka vazhduar moni-



Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Rrugore, Mit'hat Tola

PROBLEMATIKAT
"Problematikat më të shpeshta që hasim janë tejkalimi i shpejtësisë, parakalimet e gabuara, ndryshimet e papritura të korsive, përdorimi i celularëve gjatë drejtimit të mjeteve, drejtimi i mjeteve nën ndikimin e alkoolit dhe në gjendje të dehur, mospërdorimi i kaskave mbrojtëse për drejtuesit e motomjeteve".

për t'iu përgjigjur më mirë sasisë dhe volumeve të rritura të trafikut, ka vend për përmirësime në elementet e sigurisë të të gjitha rrugëve. Sistemet e sinjalizimit duhet të jenë më të përshtatshme dhe më bashkëkohore, duke iu krijuar komoditet në udhëtim drejtuesve të mjeteve. Është sjellja e drejtuesve të mjeteve që duhet të përmirësohet në një të ardhme të afërt, me qëllim që të kemi një parandalim më të mirë të aksidenteve rrugore.

Policia ka ndërmarrë fushata të shumta ndërgjegjësuere për të rinjtë, që të mos përdorin mjedin nëse konsumojnë alkool. Si kanë ndikuar këto mesazhe në parandalimin e aksidenteve rrugore?

Policia do të vazhdojë ta bëjë këtë që ju konstatoni edhe në vijim, pra përveç ndëshkimeve administrative dhe penale, Policia Rrugore do të përdorë të gjithë instrumentet në dispozicion, rrjetet sociale, mediat, shkollat publike të të gjitha niveleve, me synim ndërgjegjësimin e një numri sa më të madh përdoruesish rrugorë për risqet e alkoolit në timon si një nga vrasësit më të mëdhenj në rrugë në aksidente rrugore jo vetëm tek, ne por edhe në botë.


Çfarë këshille jepni për drejtuesit e mjeteve dhe përdoruesit e rrugës?

Rruga është ambient i përbashkët dhe secili përdorues i rrugës duhet të sillet në mënyrë sa më sociale. Respektimi i normave të sjelljes gjatë qarkullimit mund të bëjë të mundur që secili të shkojë në destinacionin e tij pa u dëmtuar, duke kontribuar kështu në rritjen e parametereve të sigurisë rrugore. Rrapi i sigurimit, mospërdorimi i celularit në timon, vendosja e kaskës mbrojtëse për drejtuesit e çiklomotorëve dhe motomjeteve janë gjëra që duhet të theksohet, që mund t'i bëjë çdo drejtues mjeti. Modernimi i shpejtësisë, evitimi i parakalimeve të gabuara, mospërdorimi i pijeve alkoolike janë këshillat për të jetuar dhe për të mos rrezikuar veten dhe të tjerët.



Familja Picaku hap dyert e moritit, mbërrin në Durrës trupin e të riut të vrarë në Itali

DURRES- Janë hapur dyert e moritit në familjen Picaku që jeton në zonën e ish-Kënetës. Trupi i pajetë i mirditorit që u ekzekutua në Itali disa ditë më parë në sy të vëlait për motive që ende nuk janë sqaruar nga policia italiane, mbërriti dje në Shqipëri përmes portit të Durrësit, rreth orës 08:30 të mëngjesit. Trupin e pajetë të Picakut e kanë marrë familjarët dhe të afërmit e tij, duke iu drejtuar me pas banesës, ku familja jeton në kushte të vështira ekonomike. 24-vjeçari Viktorian Picaku u vra më 2 gusht në sheshin "Abazzia" në Bari të Italisë. Ai u ekzekutua me 2 plumba një në kokë dhe një në mushkëri. Picaku ndërroi jetë menjëherë pas të shtënave. Në momentin e sulmit me të ishte edhe vëllai i tij. Dy autorët e dyshuar që vranë të riun shqiptar janë vetëdorëzuar 24 orë pas ngjarjes në polici. Familjarët thanë se shkaku i vrasjes ishte sherri për një vajzë. Dy ditë më parë, komuniteti shqiptar në Korato organizoi një manifestim për të mbledhur fonde për transportimin e trupit të pajetë të 24-vjeçarit në Shqipëri. Ky komunitet siguroi fonde si për transferimin e trupit të pajetë drejt Shqipërisë, ashtu edhe për ceremoninë e varrimit në Durrës.



torimin dhe ka koordinuar strukturat e shërbimit policore lidhur me situatën e rendit dhe të sigurisë publike në plazhe e pika të tjera pushimi, qarkullimin në akset rrugore, fluksin e hyrjes së mjeteve dhe shtetasve në PKK etj.

Sa është numri i aksidenteve për vitin 2018, në krahasim me vitet e kaluara?

Duke krahasuar të dhënat statistike me 7-mujorin e parë të vitit 2017 deri në datën 31.07.2018 kanë ndodhur 90 aksidente më pak, 17 të vrarë më pak, 26 të plagosur më pak, 191 të plagosur lehtë më pak, 17 të vrarë më pak, 26 të plagosur më pak, 191 të plagosur lehtë më pak,

të plagosur lehtë më pak.

Në lidhje me këto raste, sa shtetas janë arrestuar për shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor?

Gjatë 7-mujorit të parë të vitit 2018 nga të dhënat operative dhe zyrtare janë arrestuar 1401 drejtues mjete gjithsej. Konkretisht, 634 raste për përdorim alkooli, 767 persona për drejtim të mjetit pa leje drejtimi.

Cilat janë problematikat më të shpeshta që hasni nga drejtuesit e automjeteve?

Problematikat më të shpeshta që hasim janë tejkalimi i shpejtësisë, par-

akalimet e gabuara, ndryshimet e papritura të korsive, përdorimi i celularëve gjatë drejtimit të mjeteve, drejtimi i mjeteve nën ndikimin e alkoolit dhe në gjendje të dehur, mospërdorimi i kaskave mbrojtëse për drejtuesit e motomjeteve.

Mund të përmendni disa prej akteve rrugore më problematike, që janë më të predispozura për shkaktimin e aksidenteve?

Në tërësi rrjeti rrugor shqiptar ka pësuar përmirësime të ndjeshme vitet e fundit, por referuar rritjes së metesatares të shpejtësisë me të cilën po qarkullojnë mjetet,

Njoftim për shitje me anand

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e dorëzuesit K S të ndodhur në Panchoro Matiashter. Pasuria që shitet në ankand përbehet nga:

- Pasuria "Are" me nr. 206/48 vol. 5 fq 31, me siperfaqe 2500 m2 ZK 2869 me cmm 1.500.000 lek
- Pasuria "Are" nr. 206/7 me vol 4, faqe 244, siperfaqe 500 m2 ZK 2869, me cmm prej 100.000 lek
- Pasuria me nr. 70/15, vol 6, faqe 85 me siperfaqe 51 m2 e ndodhur në zonën Kadastrale 2869 me cmm në masën 520.822 lek

Ankandi eshte progresiv e do të zhvillohet di 16.08.2018 në orën 15:00 në Bulv "G.Fishta" Kulla 1, Kati 2, zyra 5. Kont tel. 672082543, e-mail: llir_dervishaj@yahoo.com, WEB: www.powerjustice-al.com.

STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON" me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA

Di. 08.08.2018 ora 16:00
Përfundon Ankandi i Parë për pasurinë:

- Pasuria "Truall-Ndërtesë" me sip.529.25 m2, me adresë Sallimone, Durrës. Me çmim 40 000 Euro
- Pasuria "Arë" me sip.3750 m2, me adresë Hardhishtë, Durrës. Me çmim 22 400 Euro

Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Blv.kryesor (ish kinma liria) ,Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575

Shitje me Anand te Pare nga Studio Permbarimore L.D.C

"Ndertese", me siperfaqe 600 m2, me Nr. Pasurie 495/15, Vol 5, fq. 83, ndodhur ne ZK 3426 me adrese ne Tufine, Tiranë. Regjistruar ne Z V R P P Tiranë ne emer te Zyber KUKA. Çmimi fillistar per shitje eshte 3.360.000 Leka.

Data e shpalljes 01.08.2018
Data e zhvillimit 24.08.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslim Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

DURRËS - Një ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në lagjen nr.7 të qytetit të Durrësit, ku Merita Hajdari u gjet e vdekur me një plumb në kokë, policia lokale ka arrestuar bashkëshortin e saj, Sherif Hajdari. Mësohet se Hajdari, punonjës policie në portin e Durrësit akuzohet se e ka shtyrë gruan e tij 47-vjeçare drejt vetëvrasjes. Ndërkohë, pas hetimeve të kryera nga grupi hetimor, është vërtetuar me prova shkencore se nëna e dy



Viktima Merita Hajdari

Akuzohet se ka shtyrë gruan drejt vetëflimit

Misteri i vetëvrasjes së Merita Hajdarit, përfundon në pranga bashkëshorti polic

djemve të rritur u vetëvra me armën e shërbimit të burrit të saj. Mësohet se pas ngjarjes, ishte vetë efektivit që lajmëroi sallën operative të policisë për krimin në familje. Burime nga grupi hetimor pohuan se gjatë marrjes në pyetje, Sherif Hajdari

ka deklaruar se bashkëshortja i kishte marrë armën dhe kishte qëlluar veten pas debatit që ata kishin pasur. Ai nuk ka dhënë shumë detaje mbi motivin e konfliktit, por është shprehur se kohët e fundit marrëdhënia mes tyre ishte mjaft

e tensionuar. Gjithashtu, policia ka marrë në pyetje edhe familjarë të viktimës, të cilët treguan se nga jashtë banesë kishin dëgjuar sherrin me çiftit, ndërsa thanë kur hynë në banesë, panë gruan të vranë me armë zjarri. "Dëgjuam që çifti po zihje

dhe po bërtisnin. Por nuk ishim brenda në shtëpi në atë moment. Kur hymë brenda në banesë, Merita ishte pa shenja jeta. Por nuk pamë se çfarë ndodhi", kanë pohuar të afërmit e viktimës. Nisur nga këqyrja e vendit të ngjarjes, por edhe dëshmi të dhëna, policia dyshon se nëna e dy fëmijëve është vetëvra me një plumb në kokë. Do të jetë aktespertiza që do të hedhë dritë mbi këtë ngjarje, duke saktësuar nëse bëhet fjalë për vrasje apo vetëvrasje.

Policia, masa shtesë sigurie për mbarëvajtjen e aktivitetit gjigant

KORÇË

Në qytetin e serenatave sot nis Festa e Birrës. Një festë kjo tradicionale e përvitshme, që mbledh në Korçë jo vetëm vizitorë shqiptarë, por edhe qindra turistë të huaj që presin të shijojnë birrën e famshme shqiptare, "Birra Korça", që i ka dhënë edhe emrin kësaj feste. Çdo gjë është gati në Korçë, ku janë ngritur stendat dhe është krijuar infrastruktura e nevojshme. Për më tepër, policia e Korçës ka marrë masa shtesë për të siguruar mbarëvajtjen e aktivitetit dhe për të mos lejuar asnjë cenim të sigurisë. Ashtu si çdo vit, kjo festë parashikohet të ketë një rekord pjesëmarrësish, ndërsa hotelet në Korçë kanë nisur me kohë prenotimet për të pritur jo vetëm përdoruesit që dinë të vlerësojnë shijen e birrës me të mirë, por edhe adhuruesit të traditave të qytetit. Edhe në këtë edicion organizatorët e festës janë kujdesur në detaje për të sjellë një program muzikor mjaft të mirë, me emrat më të njohura të muzikës shqiptare dhe jo vetëm, ndërsa hyrja për të gjithë vizitorët vendës e të huaj që do të marrin pjesë në festë do të jetë falas. Festa me e madhe verore në Shqipëri do të vijë e organizuar në dy pole, tek Pazarit i Vjetër dhe tek sheshi para stadiumit "Skënderbeu". Vizitorët vendës e të huaj do të bëhen pjesë e saj për 5 net me radhë. "Birra Korça" këtë vit vihet edhe më tepër në qendër të vëmendjes, pasi bëhet fjalë për një vit jubile, i cili përkon me 90-vjetorin e krijimit të saj, ndërsa organizatorët premtojnë surpriza të mëdha. Turistët dhe të apasionuarit e festës do të kenë mundësi të shijojnë birrën, e cila është vlerësuar edhe nga ekspertët ndërkombëtarë si një prej birrave më cilësore. Veç birrës, pjesëmarrësit do të kenë mundësi të shijojnë edhe gatimet tradicionale.

Nis Festa e Birrës, turistët vendës dhe të huaj "dynden" në Korçë

5 net argëtim, muzikë e birrë deri në mëngjes



për bllokimin e lëvizjes së automjeteve nga vendi i quajtur "Lëndina e Lotëve", Pallati i Sportit, Qendra e Trajimit të Studentëve, drejt Unazës së Stadiumit si edhe në rrugën "Niko Kovaç" (rruga e dritave të verdha) duke filluar që nga data 08.08.2018, ora 10:00. Sgarojmë të gjithë pjesëmarrësit se organizatorët kanë marrë masa për lehtësimin e parkimit pranë kompleksit

sportiv, në afërsi të stadiumit. Ndërkohë do të lejohet hyrja në Unazën Lindore dhe Veriore të stadiumit, vetëm për automjete apo subjekte të veçanta që janë të autorizuara nga organizatorët e këtij eventi. Përgjatë sheshëve dhe bulevardëve kryesore të qytetit, "Republika" dhe "Gjergj Kastrioti", ku ka përqendrim dhe qarkullim të madh njerëzish e mjeteve do të ketë

shërbime të shtuara të punonjësve të policisë, të cilët do të mbikëqyrin ruajtjen e rendit, do të ndërhyjnë në zgjidhjen e problemeve, si edhe do të parandalojnë krijimin e situatave të ndryshme, të cilat mund të cenojnë sigurinë publike. Në varësi të fluksit të mjeteve, Policia Rrugore do të marrë masa për orientimin dhe disiplinimin e lëvizjes së para, gjatë,

por edhe pas përfundimit të aktivitetit, deri në normalizimin e saj. Këshillohen të gjithë drejtuesit e mjeteve që të shmangin lëvizjet e shtuara me mjet përgjatë këtyre ditëve, të respektojnë rregullat e qarkullimit rrugor duke kufizuar përdorimin e pijeve alkoolike, të vendosin rripin e sigurimit dhe kaskën mbrojtëse, të mos përdorin celularin gjatë drejtimit të mjetit, me qëllim shmangien e ngjarjeve të mundshme rrugore. Shërbimet e Rendit do të kujdesen gjithashtu për të mbajtur kontakt të vazhdueshëm me drejtuesit e objekteve me rëndësi të veçantë si nënstationet elektrike, ujësjellësi etj., për të forcur masat e ruajtjes së tyre. Të gjithë qytetarët të cilët ndeshen me probleme apo shqetësime të ndryshme janë të lutur të telefonojnë tek nr. 129 i Policisë së Shtetit, pasi do u sigurohet një reagim i menjëhershëm. Policia e Korçës gjen rastin t'u urorë argëtim sa më të këndshëm të gjithë pjesëmarrësve në këtë event festiv!



Furnizonin Elbasanin me heroinë, arrestohen dy shpërndarësit

ELBASAN - Dy persona kanë rënë në pranga, pasi i është kapur një sasi heroine. Mësohet se gjatë operacionit të koduar "Muzgu" u arrestuan dy shpërndarës të drogave të forta, Arjan Cani, 49 vjeç, banues në Berat dhe Arshim Piliçiqi, 27 vjeç, banues në fshatin Podgoricë të Korçës. Ndërkohë në cilësimin e provës materiale u kapën 505 gr heroine. Sipas policisë, ata u kapën në aksin rrugor Qafë Thanë-Elbasan teksa po udhëtonin me automjetet e tyre. Gjithashtu, u sekuestruan edhe dy aparate celularë dhe dy automjete në pronësi të shtetasve të arrestuar. Nga hetimet e kryera, rezultoi se Cani dhe Piliçiqi në bashkëpunim me njëri-tjetrin po transportonin sasinë e lëndës narkotike për të shitur në doza të vogla në qytetin e Elbasanit. Ndërkaq, vijojnë hetimet për identifikimin e bashkëpunorëve të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet kriminal. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për veprën penale të "Prodhimi dhe shitja e narkotikeve" e kryer në formën e bashkëpunimit.

Dyzet e katër persona, të cilët konsumuan ushqim në tri dasma të ndryshme në të njëjtin lokal në qytetin e Elbasanit përfunduan të helmuar në spital. Mësohet se dasmorët, mes të cilëve edhe dy fëmijë, u helmuan fundjavën që shkoi (të shtunën dhe të dielën) ndërsa mbërritën me urgjencë në spital me dhimbje të forta stomaku, të vjella, këputje, diarree dhe dhimbje koke. Dyshimet janë për helmim nga salmonella. Pas inspeksionit në lokalin ku ishin mbajtur dasmat, AKU vendosi bllokimin e aktivitetit si dhe gjobë në vlerën e 700.000 le-

Elbasan, AKU bllokoi lokalin ku u helmuan 44 dasmorë, nëndrejtori i spitalit: Gjendja, drejt përmirësimit

këve. Gjatë inspeksionit u sekuestruan produkte ushqimore me bazë mishi e bulmeti, të cilat mbaheshin në kushte të rënda higjieno-sanitare. Nga verifikimi i subjektit të shtetasit Manol Musaj, rezultoi se kishte mundësi të rëndë të kushteve higjieno-sanitare si dhe mungesë të dokumentacionit shoqëruar (gjurmueshmëri). Në momentin e inspeksionit në subjekt, ndodheshin 12kg mish vici, 40 kokrra veze,

25 kg mish gici, 5 kg djathë i bardhë si dhe 4 kg djathë kaçkavall pa etiketë. Për produktet e gjendura në subjekt u realizua marrja e mostrave, me qëllim kryerjen e analizave për prezencë të salmonelës", - sqaroi AKU. Ndërkaq, nëndrejtori i spitalit rajonal të Elbasanit, Luan Rrapi ka bërë me dije se në urgjencën e këtij spitali kanë shkuar 44 persona, mes tyre edhe fëmijë. Sipas tij, 31 prej

të helmuarve janë shtruar në spital. "Helmimi ka ndodhur të shtunën dhe të dielën. Pacientët kanë qenë në të njëjtin lokal në tri dasma. Ka disa të shtruar. Gatishmëria e spitalit është 100%. Deri tani ka 31 persona të shtuar, si edhe 2 fëmijë në pediatri. 3 nga personat e helmuar, të cilët kanë shfaqur edhe komplikacione më të mëdha, janë dërguar në Tiranë për mjekim më të specializuar. Ndërsa, 8



raste kanë marrë mjekim ambulator", tha Rrapi. Ai u shpreh se tashmë pacientët paraqiten në gjendje më të mirë shëndetësore.

4 vite burg për Aleksandër Zotajn

Tregtonte kokainë në Itali, dënohet sipërmarrësi shqiptar

Rimini - Një biznesmen shqiptar në Itali është dënuar nga gjykata e Riminit pasi akuzohet për trafik droge. Mediat italiane raportojnë se bëhet fjalë për 48-vjeçarin Aleksandër Zotaj. Bëhet me dije se 48-vjeçari u dënua me 4 vite burg nga gjyqtari Raffaele De Florio. Procesi ndaj tij u zhvillua me gjykim të shkurtuar, pasi Zotaj kishte pranuar krimin. Zotaj akuzohet për shpërndarje kokaine dhe

gjykata pranoi akuzën se ai ishte gati të shpërndante qindra doza. Mësohet se 48-vjeçari është ish-pronar i një qendre bukurie dhe aktualisht ortak në këtë biznes. "Libertas" shkruan se Zotaj ishte arrestuar në fund të qershorit. Sipërmarrësi shqiptar ra në pranga pasi u kap me kokainë. Ai e kishte fshehur drogën pranë makinës së tij të parkuar dhe këtë gjë e vuri re një inspektor i policisë bashkiake. Biznesmeni kishte qenë në vëzhgim



nga policia, e cila kishte dyshuar për veprimtarinë kriminale të tij. Ndërsa në cilësimin e provës iu sekuestruan 56 gramë kokainë, e cila rezultonte 80% e pastër.

Në kërkim drejtuesi i automjetit

Aksidentohet 64-vjeçari shqiptar në Itali, përfundon në koma

MILANO - Një 64-vjeçar shqiptar në Itali ka mbetur i plagosur rëndë në një aksident rrugor. Ngjarja ndodhi ditën e hënë rreth orës 11:20 në rrugën "Virgilio Ferrari" në Milano. I moshuari, i cili ishte duke lëvizur me biçikletë është përplasur nga një automjet. Mësohet se automjeti pasi përplasi shqiptarin dhe më pas i hipi sipër, fill pas ngjarjes u largua. Ndërsa 64-vjeçari përfundoi pa ndjenja në rrugë. Mediat italiane raportojnë



se aktualisht shqiptari është në koma. Kanë qenë kalimtarët e rastit, ata që kanë njoftuar ambulancën dhe

policinë, e cila ka shkuar menjëherë në vendngjarje. Sipas mediave italiane, identiteti i 64-vjeçarit ende nuk është bërë i ditur. "Milano Today" raporton se shtetasi shqiptar, si pasojë e aksidentit ka marrë plagë të rënda në kokë dhe në fytyrë, ndërsa gjendja e tij shëndetësore është kritike. Ndërkohë, policia po punon për zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe po heton rreth identifikimit të drejtuesit të mjetit, që u largua nga vendi i aksidentit.

Zbardhen shifrat, klandestinët e moshës 16-17 vjeç paguan rreth 6000 paund secili

Një gjykatë në Londër ka dënuar me burg grupin e trafikantëve që dërgonin persona ilegalisht nga Shqipëria në Angli. Banda e trafikantëve përbëhej nga shtetas britanikë dhe shqiptarë. Mes grupit të të dënuarve ishin dy shqiptarët Artur Nutaj dhe Sabah Dulaj, përkatësisht 39 dhe 23 vjeç dhe katër shtetasit britanik Wayne Bath, Albert Letchford, Leonard Poëell dhe Alfie Poëell. Të gjithë të pandehurit i kanë mohuar akuzat për ndihmesë të emigracionit të paligjshëm. Dy shqiptarët Dulaj dhe Nutaj pretenduan se ishin "agjentë udhëtimi", të cilët gjenin njerëz që dëshironin të shkonin drejt Mbretërisë së Bashkuar. Agjencia e lajmeve "Sputnik" përmes një investigimi ka zbuluar një sërë rrugësh kontrabandë të bërë nga trafikantët si dhe disa të mbetura në tentativë. Operacioni i policisë, fillimisht u përqendrua në Dymchurch, në Kent. Hetimi u drejtua nga Agjencia Kombëtare e Krimit në Mbretërinë e Bashkuar, e cila zhvilloi mbikëqyrje së bashku me autoritetet franceze gjatë katër muajve nga maji 2016. Varka u gjet nga roja bregdetare teksa po fundosej. Ajo ishte projektuar për gjashtë persona, por në të kishin hipur 20, ndër ta 18 emigrantë shqiptarë. Ajo tregoi shenja se ishte përdorur për të trafikuar emigrantë dhe përmblante sende personale. "18 emigrantë shqiptarë, të cilët kishin paguar 6000 paund secili, pothuajse u mbytën më 28 maj të vitit 2016 kur gomonia që po transportoheshin gjatë natës hasi vështirësi në kanal dhe Anglisë", shkruan "Sputnik". Ndërkohë, mësohet se emigrantët ishin të moshës 16-17 vjeç. Më herët hetue-

Trafikonin emigrantë në Angli, lihen në burg 6 pjesëtarët e bandës

Dy shqiptarët, Artur Nutaj dhe Sabah Dulaj mohojnë akuzat



HETIMI

Operacioni i policisë fillimisht u përqendrua në Dymchurch, në Kent. Hetimi u drejtua nga Agjencia Kombëtare e Krimit në Mbretërinë e Bashkuar, e cila zhvilloi mbikëqyrje së bashku me autoritetet franceze për katër muaj në 2016-ën.

6000

PAUND

"18 emigrantë shqiptarë, të cilët kishin paguar 6000 paund secili, pothuajse u mbytën më 28 maj të vitit 2016, kur gomonia që po transportoheshin gjatë natës hasi vështirësi në kanal dhe Anglisë", shkruan Sputnik.

si i lartë i Agjencisë Kombëtare të Krimit (NCA), Mark McCormack u shpreh se banda ishte e rrezikshme dhe kishte ndërmarrë veprime të përgjegjshme. "Kemi të bëjmë me njerëz pa përvojë detare, të cilët kanë zhvil-

luar kurse prej një ose dy ditësh, që përpigën të kalojnë këtë kanal, gjatë natës në një anije të vogël, të tejmbushur me njerëz", u shpreh McCormack. Grupi besohet të ketë kryer në të shkuarën një udhëtim të suksesshëm me një anije, e

cila u gjet e braktisur në plazh në Dymchurch më 11 maj 2016. Kur zyrtarët e rojës së kufirit shkuan për të hetuar, pronari Wayne Bath (i arrestuar), tregoi se kishte qenë duke peshkuar teksa varka kishte pësuar një avari në motor.



Aksident i rëndë tek rreth-rrotullimi i Saukut, humb jetën 28-vjeçari

TIRANË - Një aksident me pasojë vdekjen ka ndodhur ditën e djeshme në kryeqytet. Koncretisht tek rreth-rrotullimi i "Saukut", një automjet tip "Mercedes-Benz" ka dalë nga rruga e për pasojë ka humbur jetën 28-vjeçari Ervin Preçi, banues në Tiranë, i cili ishte pasagjer, ndërsa të plagosur rëndë kanë mbetur edhe dy persona të tjerë, drejtuesi i automjetit, L.D. dhe një femër, D. Xh. vjeç 23, banuese në Tiranë. Shkak i aksidentit dyshohet të ketë qenë shpejtësia tej normave të lejuara. "Më datë 07.08.2018, tek rreth-rrotullimi i 'Saukut', shtetasi L.D. vjeç 28,

NGJARJA

Një automjet tip "Mercedes-Benz" ka dalë nga rruga e për pasojë ka humbur jetën 28-vjeçari Ervin Preçi, banues në Tiranë, i cili ishte pasagjer, ndërsa të plagosur rëndë kanë mbetur dhe dy persona të tjerë, drejtuesi i automjetit, L.D. dhe një femër, D. Xh. 23 vjeç, banuese në Tiranë.

banues në Tiranë, duke drejtuar mjetin tip 'Benz' ka dalë jashtë rrugë dhe për pasojë janë dëmtuar drejtuesi i mjetit, shtetasi L.D. dhe pasagjerja, shtetasja D. Xh., 23 vjeçe, banuese në Tiranë, të cilët ndodhen në spital, nën kujdesin e mjekëve. Pasagjeri tjetër, shtetasi E. P., vjeç 28, banues në Tiranë, ka ndërruar jetë në spital. Po punohet për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes", njofton policia.

Udhëzimi i MASR/ Ndryshimet që janë bërë në ndihmë të viktimave të trafikimit

Voltiza Duro

Zbardhen kategoritë e tjera që do të marrin tekste shkollore falas

"Përfitojnë fëmijët e familjeve të varfra"

Vitin e ri mësimor 2018-2019 do të përfitojnë tekste shkollore falas edhe disa kategori të tjera nxënësish të arsimit parauniversitar. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot ndryshimet që janë bërë në udhëzimin e përbashkët nr. 51 të ministrit të Arsimit dhe Sportit si dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Sipas udhëzimit "Për procedurat e përdorimit të fondëve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar", do të jenë edhe 5 kategori që përfitojnë tekste pa pagesë, me kusht që t'i rikthejnë sërish në përfundim të vitit mësimor. Respektivisht do të përfitojnë falas tekste: fëmijët që ndjekin arsimin fillor nga klasa e parë deri në të katërt, nxënësit që janë i treti e më lart në radhën e shkollimit të fëmijëve të së njëjtës familje, si dhe fëmijët që janë pjesë e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, sipas ndryshimeve në udhëzim edhe fëmijët që janë viktimat e trafikimit e marrin ndihmë dhe asistencë nga Qendra Kombëtare e Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendra Kombëtare e Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencës, kanë të drejtë të marrin tekste shkollore falas. Ndërkohë në kategorinë e fundit të nxënësve të parauniversitarit që mund të marrin tekste pa pagesë, përfshihen të gjithë ata fëmijë që janë përfitues në institucionet e përkujdesit social rezidencial në Qendrën Kombëtare të Pritjes së Viktimave të Trafikimit.



KATEGORITË E NXËNËSVE QË MARRIN TEKSTE FALAS:

- > Fëmijët/nxënësit që ndjekin arsimin fillor nga klasa e parë deri në të katërt.
- > Fëmijët/nxënësit që janë i treti e më lart në radhën e shkollimit të fëmijëve të së njëjtës familje.
- > Fëmijët/nxënësit që janë pjesë e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- > Fëmijët/nxënësit që janë viktimat e trafikimit e marrin ndihmë dhe asistencë nga Qendra Kombëtare e Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendra Kombëtare e Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencës.
- > Fëmijët/nxënësit që janë përfitues në institucionet e përkujdesit social rezidencial në Qendrën Kombëtare të Pritjes së Viktimave të Trafikimit.

MASR: 11-27 gusht do të zhvillohen konkurset e pranimit

Matura Shtetërore, aplikuan rreth 25 mijë maturantë

Sipas të dhënave të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit, në përfundim të aplikimeve në universitete për raundin e parë rezultojnë se për vitin akademik 2018-2019 kanë aplikuar gjithsej 24 mijë e 287 kandidatë. Procesi i aplikimeve u zhvillua nga data 30 korrik deri në 4 gusht. Lidhur me pranimit në Institucionet



e Arsimit të Lartë janë bërë tëashmë publike edhe datat e konkurseve. Sipas udhëzimit të Ministrisë së Arsimit,

institucioni arsimor/shkollë harton procesverbal të veçantë, ku pasqyrohen kërkesa/porosia për tekste shkollore, lista e nxënësve sipas kategorive të përcaktuara e detajuar për çdo klasë/

institucion arsimor si dhe faturat tatimore për blerjen e teksteve në emër të nxënësve së bashku me aktin e marrjes në dorëzim të teksteve nga furnitori/botuesi. Kopjet origjinale të

këtij dokumentacioni dhe kërkesa për financim dërgohen zyrtarisht në njësinë arsimore vendore. - theksohet në udhëzimin e ndryshuar. Për zbatimin e këtij udhëzimi të firmosur nga

karkojnë nga portali "U-Albania" listën e aplikantëve, ndërsa në 11 deri në 27 gusht do të zhvillohen konkurset e pranimit. Ndërkohë, brenda 28 gushtit do të bëhet shpallja e listës së aplikantëve dhe renditja e tyre, bazuar në pikët e grumbulluara. Ndërsa regjistrimi i fituesve në raundin e parë do të bëhet nga 30 gusht deri në 12 shtator. Por, kandidatët për universitetet kanë të drejtë që në 13 shtator të cregjistrohen nga programi i studimit ku janë regjistruar dhe të riaplikojnë në raundin e dytë.

Lindita Nikolla dhe Arben Ahmetaj janë ngarkuar Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë si dhe njësitë arsimore vendore (DAR/ZA-ë).

ISHMP, inspektim subjekteve për prodhimin e qeseve plastike

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave për ndalimin e prodhimit, tregtimit dhe importimit të qeseve plastike, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit po kryen në mbarë vendin inspektime në subjektet që prodhojnë qeset plastike. Në një nga inspektimet e kryera në qarkun e Tiranës ka qenë e pranishme edhe zvm. ministria e Mjedisit, Ornela Çuçi, e cila ka ndjekur nga afër kontrollin në 6 kompanitë e prodhimit. Pas inspektimit rezultoi se në 5 prej tyre ishin zbatuar kriteret e reja për prodhimin e qeseve plastike me trashësi mbi 35 mikron dhe për shtimin e elementëve të biodegradueshëm. Vetëm një prej subjekteve nuk kishte respektuar kriteret dhe për pasojë inspektorët vendosën masë administrative, gjobë me vlerë 10 milionë lekë të vjetra.

Heqja e vizave për Kinën, rritet numri i turistëve

Qeveria shqiptare vendosi heqjen e vizave turistëve nga Kina për periudhën 1 prill deri në 31 tetor 2018. Heqja e vizave me Kinën për 8 muaj në vit nga qeveria shqiptare ka dhënë rezultatet e para. Numri i turistëve nga Kina drejt Shqipërisë është shumëfishuar krahasuar me një vit më parë. Falë heqjes së vizave, Kina u rendit me shpejtësi në 5 vendet me më shumë vizitorë në Shqipëri. Rritja e numrit të turistëve kinezë në vendin tonë tërhoqi edhe vëmendjen e televizionit më të madh në Kinë, CGTN, i cili përgatiti një reportazh për Shqipërinë.

Erion Veliaj: Të na bashkohen edhe bizneset

Dhurimi i gjakut, punonjësit e Bashkisë së Tiranës mbështesin nismën

jete për dikë tjetër: "Kemi kaluar të paktën 1/3 e institucioneve të bashkisë dhe besoj se deri në fund të verës të gjitha institucionet tona do kenë bërë dhurimin maksimal të gjakut, që më pas në shtator të fillojnë bizneset. Ka sot biznese që kanë më shumë staf se një drejtori e bashkisë dhe

nëse si nisma e pemëve, ashtu edhe fushata për dhurimin e gjakut shkon përtej institucioneve, pra në bizneset private, në shoqata dhe dhurues familjarë, atëherë realisht do të kemi një fushatë të suksesshme", tha Veliaj. Më tej, ky i fundit u shpreh optimist që kjo nismë do të mbështetet

masivisht nga qytetarët e Tiranës. "Kemi pasur disa fushata që i ngjajnë kësaj të dhurimit të gjakut. Një prej tyre ishte ajo e mbjelljes së pemëve. Të dyja lidhen me jetën. Ndaj, besoj se fati i kësaj nisme do të varet nga sa të përqendruar e të përkushtuar do jemi në këtë fushatë. Ash-

tu siç nisi me pemët fillimisht bashkia, më pas u bashkuan sipërmarrjet, pastaj shoqatat, familjarët, cerdhet, kopshtet, shkollat. Besoj se do të ndjekim të njëjtën strategji. Pra, gjatë kohës që njerëzit janë me pushime, bashkia ka marrë stafetën dhe po mendohe mi që në Tiranë të kemi kompletuar nevojat për 20 mijë dhurime brenda një viti", shtoi kryebashkiaku. Krahas një çështjeje me rëndësi për shpëtimin e jetës, Veliaj nënvizoi se dhurimi i gjakut është edhe emancipim për shoqërinë.



Nisma për dhurimin e gjakut për të sëmurët me talasemi do të vazhdojë deri në fund të muajit nga punonjësit e Bashkisë së Tiranës. Ndërkohë, në shtator kësaj fushate pritet që t'i bashkohen edhe bizneset e kryeqytetit. Ditën e djeshme Punonjësit e Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit dhuruan gjak për të sëmurët me talasemi dhe personat në nevojë. Kryebashkiaku Erion Veliaj theksoi se çdo qytetar që i bashkohet kësaj nismë ndihmon në dhurimin e një

KUFIJTË E KOSOVËS DEBATET

Presidenti ua lë në dorë kosovarëve: Të vendosin ata për kufijtë

Berisha reagon ndaj Thaçit: S'pastrohesh dot me mbetje të kuzhinës së Beogradit

Debati për kufijtë, kreu i Kosovës propozon referendumin

Pamela Aliaj

Pas akuzave të bëra tri ditë më parë, ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha i është përgjigjur Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi pas kundërshtimit të idesë së tij për korrigjim të kufijve me Serbinë. Berisha ka folur dje për këtë çështje, duke i quajtur mjerane komentet e Thaçit, e më tej se kërkon të pastrojë fytyrën me mbetje e kuzhinës së Beogradit. "Nuk ka mjerim më të madh se sa të përpiqesh ta pastrosh fytyrën me mbetje e kuzhinës së Beogradit. Kjo është e vetmja përgjigje që kam", ka deklaruar Berisha për presidentin kosovar, Hashim Thaçi. Ai ka folur edhe për gjitha çështjet që ka ngritur Thaçi lidhur me figurën e tij, por që nuk i ishte drejtuar konkretisht me emër. Berisha është përgjigjur edhe për akuzat nëse ka arrestuar Adem Jasharin dhe komandantët e tjerë të UÇK-së, për embargon e naftës kundër Jugosllavisë, strehimin ose jo të Arkanit dhe Bin Ladenit në Shqipëri në kohën sa Berisha ishte në pushtet. Ai ka komentuar edhe nëse kishte pasur ftohje të marrëdhënieve me Rugovën dhe nëse e kishte përkrahur Demaçin me politikë më radikale. Ndërsa tri ditë më parë, Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi e ka përdorur Ibrahim Rugovën për të akuzuar Sali Berishën se është kundër shqiptarëve të Kosovës. Thaçi ka thënë se sa ishte gjallë Rugova, nuk kishte lejuar që Sali Berisha as të mos shkelte në Kosovë. "Këta që sot kundërshtojnë vullnetin e shqiptarëve të Preshevës, Bujanovcit e Medvegjës për bashkim me Kosovën, janë të njëjtët që Presidenti Rugova për së gjalli nuk i lejoi ta shkelin tokën e Kosovës. Këshillat e tyre i takojnë kohës së turpit të historisë shqiptare", ka shkruar Thaçi në një reagim që e ka bërë kundër Sali Berishës. Por Hashim Thaçi, në një kohë tjetër, paralajmëronte dënimin e Ibrahim Rugovës. Madje, paralajmëronte dënimin të rënda për ish-udhëheqsin e shqiptarëve të Kosovës, i cili gjatë luftës ishte zënë rob në Beograd bashkë me familjen e tij. "Veprimet e tilla antikomuniste të Rugovës do të dënohen rëndë", thoshte Thaçi më 1999 për Ibrahim Rugovën. Ndërkohë, Presidenti Thaçi flet fjalë të mira tanimë për Ibrahim Rugovën. Dikur fjalë të mira kishte edhe për Sali Berishën, të cilin e quante lider dhe burrështetas. Mirëpo, Thaçi në atë kohë, më 2013-ën, fliste mirë për Berishën meqë i njëjti ishte edhe shef i qeverisë shqiptare. "I nderuar, kryeministër Berisha, ju keni dhënë kontribut të pamohueshëm për fitoren e demokracisë në Shqipëri, keni mbështetur vazhdimisht aspiratat e popullit të Kosovës për liri, pavarësi, sovranitet dhe



Hashim Thaçi



Sali Berisha

DEKLARATA E BERISHËS

"Nuk ka mjerim më të madh se sa të përpiqesh ta pastrosh fytyrën me mbetje e kuzhinës së Beogradit. Kjo është e vetmja përgjigje që kam", ka deklaruar Berisha për presidentin kosovar, Hashim Thaçi.

Debati për kufirin, ja kërkesa e serbëve dhe kosovarëve

Organizatet e shoqërisë civile, letër Mogherinit: Kundër shkëmbimit të territorit

Pas valës së gjatë të debateve lidhur me kufirin, organizatat e shoqërisë civile nga Kosova dhe Serbia i kanë dërguar një letër të hapur përfaqësueses së lartë për Politikë të Jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, në të cilën shprehen kundër ndarjes apo shkëmbimit të territoreve në vija etnike. Siç raportojnë mediat kosovare, në këtë letër thuhet se zhvillime të tilla do të prodhonin një efekt edhe tek vendet e tjera të Ballkanit.

Pjesë nga letra drejtuar Mogherinit
"Një shoqëri që zhvillohet në vlerë që kundërshtojnë respektin për të drejtat themelore të njeri-



ut dënohet me nacionalizmin, izolimin dhe mungesën e shpresës. Gjithnjë e më shumë të rinj po largohen tashmë nga vendet tona dhe territoret për të cilat elitat kombëtare dhe politike po luftojnë sot do të luftojnë pa forcat lëvizëse demokratike. Organizatat e shoqërisë civile ftojnë bashkësinë ndërkombëtare, por

